



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETTIT

Nr. 1823 Prot.

Tiranë, më 20. 10. 2020

Lënda: Raport përmbledhës për sezonin turistik veror 2020.

Drejtuar: z. Blendi KLOSI
MINISTËR
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Tiranë

I nderuar z. Ministër,

Agjencia Kombëtare e Bregdetit (më poshtë AKB), në kuadër të sezonit turistik veror 2020, në mbështetje të Ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", i ndryshuar, Ligjit Nr. 10433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 569, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar, Urdhërit të Përbashkët Nr. 353, datë 29.05.2020 mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për Miratimin e "Protokollit i Masave Anti- Covid 19 përgjatë sezonit turistik", Ju përcjell bashkëngjitur informacionin si më poshtë vijon:

I. Hyrje

AKB gjatë gjithë sezonit turistik ka qenë prezente në terren për monitorimin dhe verifikimin e të gjitha veprimtarive turistike të zhvilluara në zonën bregdetare. Monitorimi u realizua në bashkëpunim dhe me Agjencitë Rajonale të Bregdetit:

- Agjencia Rajonale Lezhë (mbuloi zonën nga fshati Adriatik i ish-komunës Fushë/Kuqe i cili ndan me fshatin Ishëm të Durrësit dhe në kufirin verior kufizohet me Lumin Buna, skaji verior i ish-komunës Velipojë);
- Agjencia Rajonale Durrës (e cila mbuloi zonën nga Plazhi i Gjirit të Lalzit deri në Plazhin e Divjakës (Laguna e Karavastasë), si dhe plazhin e Pogradecit;
- Agjencia Rajonale Vlorë (e cila mbuloi zonën nga grykederdhja e lumit të Semanit (plazhi i Seman) deri në Dhërmi.
- Agjencia Rajonale Sarandë (e cila ka kryer monitorimin e të gjithë vijës bregdetare të njohur si Riviera Shqiptare nga Rugët e Bardha në Palasë deri në Kepin e Stillos kufiri jugor me Greqinë).

Të dhënat nga sezoni turistik veror 2020:

Kërkesat dhe kriteret e plazheve për çdo bashki	Lezhë	Shkodër	Rrogozhinë	Divjakë	Durrës	Kavajë	Fier	Vlorë	Himarë	Sarandë	Pogradec	Total
Parcela të dhëna me qera	190	130	43	14	415	116	51	145	152	126	29	1411
Kontrata	86	64	39	14	199	73	51	136	151	123	29	965
Pika e vrojimit	86	64	39	14	199	73	51	136	151	123	29	965
Vrojtes i certifikuar	86	64	39	14	199	73	51	136	151	123	29	965
Parcela Publike (Plazha publik)	35	50	35	2	187	64	9	22	64	6	11	485
Të ardhura sipas bashkive	32.623.021	38.769.850	17.554.200	37.200.00	76.957.440	27.771.00	4.254.550	28.700.000	40.000.00	52.788.305	2.886.000	326.021.366

- Në sezonin turistik veror 2020 u konstatuan 18 subjekte pa kontratë, të cilët janë gjithur nga Inspektoriatit i Turizmit.

Të dhënat nga sezoni turistik veror 2019:

Kërkesat dhe kriteret e plazheve për çdo Bashki	Lezhë	Shkodër	Rrogozhinë	Divjakë	Durrës	Kavajë	Fier	Vlorë	Himarë	Sarandë	Pogradec	Total
Kontrata	73	57	27	15	19	60	79	198	156	109	25	818
Pikë vrojtimi	53	31	24	8	94	30	16	174	54	66	12	562
Vrojtes i certifikuar	28	20	24	5	50	18	0	145	31	74	13	408
Të ardhura sipas bashkive	28.438.000	31.047.000	16.247.800	2.417.412	48.407.050	31.754.700	3.412.000	32.000.000	45.000.000	39.000.000	2.440.000	280.163.962

- Për sezonin turistik veror 2020 kanë operuar 147 subjekte me kontratë më tepër në krahasim me numrin total të subjekteve me kontratë që kanë operuar në sezonin turistik veror 2019.
- Këtë sezon turistik veror 2020, numri i pikave të vrojimit është rritur me 403 pika vrojimi më tepër në krahasim me vitin 2019.
- Vrojtesit e certifikuar janë rritur me 557 persona më tepër, në krahasim me sezonin turistik veror 2019.
- Të ardhurat nga sezoni turistik 2020, nga dhënia me qera e hapësirave publike (plazhe), janë rritur me +16.4%, në krahasim me sezonin turistik veror 2019.

II. Ecuria e sezonit turistik veror.

1. AKB, në kuadër të sezonit turistik veror 2020, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 *Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"*, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424 datë 27.05.2020 Për një shtesë në vendimin Nr. 171 datë 27.03.2019 *"Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit "*, ka proceduar me nënshkrimin e kontratave për përdorimin e hapësirave të plazhit me subjektet në të gjithë zonën bregdetare.
2. Pas nënshkrimit të kontratave me subjektet dhe Njësitë Vendore është vijuar dhe me shpërndarjen e sipërfaqeve të plazhit për subjektet e kontraktuara, sipas planvendosjeve të plazhit, në varësi të sipërfaqes së negociuar dhe paguar nga çdo subjekt, sipas përcaktimeve të VKM 424/2020.
3. Konkretisht, pas miratimit përfundimtar nga *"Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA)"*, për sezonin turistik veror 2020, janë nënshkruar në total **965 kontrata për përdorimin e hapësirës së plazhit për ushtrimin e veprimtarisë së ushtrimit të stacionit të plazhit, me një total prej 1411 parcela plazhi:**

Nr.	Bashkia	Kontrata lidhura të	Numri sipas parcelave
1	Lezhë	86	190
2	Shkodër	64	130
3	Durrës	199	415
4	Kavajë	73	116
5	Rrogozhinë	39	43
6	Divjakë	14	14
7	Pogradec	29	29
8	Fier	51	51
9	Vlorë	136	145
10	Sarandë	123	126
11	Himarë	151	152
TOTAL		965	1411

*(Shënim: Të dhënat e me emrat e subjekteve janë të paraqitura në ANEX I të këtij materiali).

4. Në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit Nr. 39, datë 29.07.2020 për *"Inspektimin e Veprimtarisë së Stacioneve të Plazhit"*, të ndryshuar, ka filluar dhe inspektimi në zonën bregdetare dhe bregliqenore, nga ku janë evidentuar të dhënat si më poshtë vijon:

Bashkia	Zona	Veprimtaria	Nr. Kontrollesh Gjithsej	Verifikime për kontratën	Inspektime	Masa administrative	Gjoha	Vlera e gjobave/lekë	Paralajmë rime
Vlorë	Uji Ftohtë/Radhimë	Stacion Plazhi	48	28	20	13	3	600,000	10
Himarë	Dhërm/Himarë/Borsh	Stacion Plazhi	67	45	22	21	5	1,000,000	16
Durrës	L.13/Gjiri i Lalzit	Stacion Plazhi	56	44	12	4	2	400,000	2
Kavajë	Golem/Querret	Stacion Plazhi	53	41	12	5	1	200,000	4
Lezhë	Shëngjin/Tale	Stacion Plazhi	34	22	12	7	1	200,000	6
Shkodër	Velipoje	Stacion Plazhi	31	25	6				
Rrogozhinë	Spille	Stacion Plazhi	18	17	1	1	1	10,000	
Sarandë	Sarandë/Ksamil	Stacion Plazhi	48	30	18	12	3	600,000	9
Pogradec	Tushemisht/Pogradec	Stacion Plazhi	25	16	9	7	1	200,000	6
Divjakë	Divjakë	Stacion Plazhi	13	10	3				
Përmet	Vjosë, Përmet	Udhërrëfyes Turistik	1		1	1	1	100,000	
Total			394	278	116	71	18	3,310,000	53

5. Në lidhje me të ardhurat e grumbulluara nga sezoni turistik veror 2020, në bazë të të dhënave të siguruara nga kontakti me njësitë vendore situata paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Bashkia	Të ardhura 2020 nga stacionet e plazhit/ lekë
1	Lezhë	32.632.021
2	Shkodër	38.769.850
3	Rrogozhinë	17.554.200
4	Kavajë	27.771.000
5	Divjakë	3.720.000
6	Durrës	76.957.440
7	Fier	4.254.550
8	Pogradec	2.886.000
9	Vlorë	28.700.000
10	Sarandë	52.788.305
11	Himarë	40.000.000
TOTALI		326.021.366

6. Mbarëvajtja e sezonit turistik veror 2020, si dhe zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar, kanë qenë fokusi i takimeve që Drejtori i Përgjithshëm i AKB-së ka realizuar me Kryetarët e Njësive Vendore. Këto takime janë përqëndruar në disa pika kryesore:

- Zbatimi i planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2020;
- Ecuria e procesit për përcaktimin e zonave për ankorimin e mjeteve lundruese argëtuese, korridorët e hyrje daljeve dhe përgatitja e hartës përkatëse për plazhet;
- Sinjalistika në plazhe etj.

7. Si rezultat i pandemisë COVID 19, kontaktet me njësitë vendore kanë qenë intensive, si dhe me përfaqësues të subjekteve, të cilët kanë qenë të pasigurtë mbi ecurinë e situatës. Me ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 *Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit* me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 424 datë 27.05.2020 Për një shtesë në vendimin Nr. 171 datë 27.03.2019 *"Për miratimin e Rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit "*, specialistët e AKB-së kanë punuar intensivisht në terren për orientimin e subjekteve për ndjekjen e procedurave në sistemin e-Albania lidhur me aplikimet për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit.
8. Nga AKB janë ushtruar një sërë verifikimesh në zonën bregdetare dhe bregliqenore, të bazuara në:
- Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit Nr. 31, datë 01.07.2020 për *"Për verifikimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, strukturave akomoduese dhe plazheve publike"*, ku janë orientuar të gjithë subjektet mbi rëndësinë e procesit të plotësimit të kriterëve dhe standarteve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe janë plotësuar akt konstatimet sipas formatit të përcaktuar në ANEX II të këtij raporti.
 - Për periudhën ku është ushtruar monitorimi i subjekteve 02.07.2020-17.07.2020, të dhënat e grupuara për zonat e monitoruara janë depozituar pranë njërive vendore përkatëse, Prefekturave të Qarkut dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
 - Pjesë e verifikimeve të subjekteve, nga ana e AKB, ka qenë dhe zbatimi i Urdhërit të Përbashkët Nr. 353, datë 29.05.2020 mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit *Për miratimin e "Protokolli i Masave Anti - Covid 19 përgjatë sezonit turistik"*.
 - Subjektet gjatë plotësimit të aktkonstatimit janë informuar mbi rëndësinë e plotësimit të kriterëve që duhet të ofrojë një stacion plazhi, veçanërisht kriteret që lidhen me sigurinë në plazhe dhe reapektimin e protokollit të masave Anti Covid-19.
9. Në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKB –së Nr. 46, datë 06.08.2002, për *"Plotësimin e Dokumentit të monitorimit për subjektet që operojnë me veprimtarinë e Stacionit të Plazhit"*, janë monitoruar të gjitha subjektet që operojnë me veprimtarinë e stacionit të plazhit në të gjithë vijën bregdetare dhe bregliqenore. Dokumenti i monitorimit i mbajtur në subjekt është plotësuar sipas formatit të përcaktuar në ANEX III të këtij materiali, në varësi të tipologjisë së plazhit në plazh të tipit A ose plazh të tipit B.

III, Të dhënat sipas Agjencie Rajonale të AKB-së:

1. Agjencia Rajonale e Bregdetit Lezhë, nën juridiksionin e së cilës kanë qenë Bashkia Lezhë dhe Bashkia Shkodër dhe ku situata me nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe praninë e vrojtuesve të plazhit, paraqitet si më poshtë vijon:

BASHKIA LEZHË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
86	87	1	86	86

1.1 Plazhi Shëngjin:

- a) Përgjatë sezonit turistik 2020 në plazhin Shëngjin është konstatuar se subjektet të cilët ushtrojnë veprimtarinë si stacion plazhi kanë plotësuar kushtet dhe kriteret në zbatim të VKM Nr.171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit", të ndryshuar.
- b) Përgjatë këtij sezoni turistik në plazhin e Shëngjinit nuk ka patur prani të mbetjeve urbane, pasi njësisia vendore, Bashkia Lezhë ka trajtuar me prioritet problemin e mbetjeve duke marrë masat e duhura për mospërhapjen dhe evadimin në kohë të tyre.
- c) Këndet e lojrave, të cilat përgjatë sezoneve të shkuara janë vendosur në brezin e rërës, duke krijuar shqetësim për bizneset dhe pushuesit, këtë sezon nuk janë lejuar dhe janë sistemuar në fund të plazhit duke minimizuar shqetësimet për shkak të tyre.
- d) Problematike mbetet prania e shitësve ambulantë në bregun e detit, por nga ana e Bashkisë Lezhë është ndërhyrë disa herë për moslejimin e tyre në bregun e detit.
- e) Plotësimi i kriterëve të sigurisë nuk është realizuar në pjesën e plazheve publike.

1.2 Plazhi Tale:

Gjatë monitorimit të përgjithshëm dhe kontrollit për plotësimin e dokumentit të monitorimit janë evidentuar disa problematika në këtë plazh, si më poshtë vijon:

- a) Parkimi i paorganizuar i automjeteve të pushuesve pranë fashës ranore.
- b) Prania e shitësve ambulantë në vijën bregdetare.
- c) Plazhet publike nuk plotësojnë kriteret minimale të sigurisë dhe është evidentuar mungesa e vrojtuesve të plazhit. Në disa nga plazhet publike, mbulimi i zonës është kryer nga vrojtuesit e plazhit të subjekteve private të vendosura në anë të tyre.
- d) Disa nga subjektet kanë patur mangësi në plotësimin e kriterëve që lidhen me sinjalistikën informuese dhe markimin e zonës së notimit;

BASHKIA SHKODËR				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
64	64	0	64	64

1.3 Plazhi Velipojë

- Gjatë këtij sezoni në Plazhin Velipojë është vënë re mungesa e menaxhimit të mbetjeve urbane duke shkaktuar probleme dhe shqetësim për pushuesit dhe subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin si stacion plazhi.
- Përgjatë sezonit turistik 2020, në Plazhin e Velipojës problematike ka qenë situata dhe me praninë e shitësve ambulantë në bregun e detit.

1.4 Bashkia Lezhë ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun 35 parcela publike, ku ndër të tjera është konstatuar:

- Mungesë e pikave të vrojtimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit).

1.5 Bashkia Shkodër ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun 50 parcela publike, ku ndër të tjera është konstatuar:

- Mungesë e pikave të vrojtimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit).

2. Agjencia Rajonale e Bregdetit Durrës, nën juridiksionin e së cilës kanë qenë Bashkia Durrës, Bashkia Kavajë, Bashkia Rogozhinë, Bashkia Divjakë, Bashkia Pogradec dhe ku situata me nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe praninë e vrojtuesve të plazhit, paraqitet si më poshtë vijon:

2.1 Bashkia Durrës

- Plazhi Gjiri i Lalzit;
- Plazhi Hamallaj;
- Plazhi Katundi i Ri;
- Plazhi Currila;
- Plazhi i Durrësit;
- Plazhi Shkëmbi i Kavajës;

2.1.1 Nga monitorimi i këtyre plazheve është konstatuar se subjektet janë të pajisur me kontratë për përdorimin e stacionit të plazhit dhe kanë respektuar kriteret minimale të përcaktuara në VKM

Nr. 171 datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar dhe ndër të tjera këtë sezon turistik ndërmorën dhe masat e nevojshme në kuadër të situatës me COVID-19 dhe zbatimin e protokollit Anti-Covid 19, duke përfshirë:

- a) Vendosjen në dispozicion të pushuesve të një dushi me ujë të ëmbël;
- b) Vendosjen në dispozicion të pushuesve të paktën 2 shërbime higjienike veç për burrat veç për gra;
- c) Vendosjen në dispozicion të pushuesve të 2 kabinave zhveshje të ndara;
- d) Pajisjen me konteinerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;
- e) Të gjithë subjektet të pajisur me kontratë për përdorimin e stacionit të plazhit kanë siguruar praninë e një vrojtuesi të licensuar në stacionin e plazhit me qëllim mbarëvajtjen e sezonit turistik dhe mbrojtjen e jetës për pushuesit;
- f) Asnjë subjekt i pajisur me kontratë për përdorimin e stacionit të plazhit nuk ka vendosur elementë ndarës në tokë ose ujë;
- g) Të gjithë subjektet të pajisur me kontratë për përdorimin e stacionit të plazhit kanë patur në pikën e vrojtimit pajisjet e domosdoshme të vrojtuesit të licensuar;

BASHKIA DURRËS				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
199	202	3	199	199

2.2 Bashkia Kavajë:

- a) Plazhi i Golem;
 - Në këtë zonë u vu re një shtim i ndërhyrjes së njësisë vendore Bashkia Kavajë për pastrimin e zonës nga mbetjet urbane, investime në shtimin e pedonale që e lidh këtë zonë me pedonalen e Shkëmbit të Kavajës.
 - Gjatë monitorimit në terren dhe pas sinjalizimeve të marra u vu re që dy subjekte operonin në zona të përcaktuara për plazh publik, u sinjalizuan dhe menjëherë u morën masa për lirim të parcelave për ti vënë në dispozicion të publikut dhe vendosjen e tabelave përcaktuese të këtyre zonave Plazh Publik. Këto ndërhyrje janë realizuar në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, Prefekturën Tiranë dhe Bashkinë Kavajë.
 - Parcelat e tjera të vendosura për përdorim publik kanë qënë të lira dhe në dispozicion të publikut.

b) Plazhi i Qerret;

- Në këtë zonë u vu re që ndërhyrjet për heqjen e mbetjeve dhe pastrimin e vijës bregdetare ishin të vazhdueshme.
- Zonat e dedikuara për publikun në zonë kanë qenë të lira dhe në dispozicion të publikut.

c) Plazhi i Gjeneralit

- Në këtë zonë operon vetëm një subjekt i cili është i pajisur me kontratë për shfrytëzimin e zonës bregdetare si stacion plazhi, zonë e cila është pastruar gjatë gjithë kohës.

BASHKIA KAVAJË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
73	74	1	73	73

2.3 Bashkia Rrogozhinë

a) Plazhi Spille

- Nga monitorimi në terren është konstatuar se zona është pastruar në mënyrë të vazhdueshme nga Ndërmarja e Shërbimeve pranë Bashkisë Rrogozhinë.
- Nga monitorimi i kryer në terren është evidentuar se subjektet plotësojnë kushtet e sigurisë dhe të higjenës.
- Zonat e dedikuara për përdorim publik përgjatë gjithë vijës bregdetare kanë qenë të lira dhe në dispozicion të publikut, të pajisura me tabelat përkatëse që e përcaktojnë zonën si “Plazh Publik”.

BASHKIA RROGOZHINË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
39	39	0	39	39

2.4 Bashkia Divjakë

a) Plazhi Divjakë

- Gjatë monitorimit në terren u vu re se zona është pastruar në mënyrë të vazhdueshme nga struktura e pushtetit lokal.
- Subjektet që oprojnë në vijën bregdetare zbatojnë kushtet e sigurisë dhe të higjenës duke zbatuar dhe masat për parandalimin e shpërdarjes së Covid-19.
- Zona bregdetare ka nevojë për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
- Zonat e dedikuara për plazh publik kanë qenë të lira dhe në dispozicion të publikut.

BASHKIA DIVJAKË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
14	14	0	14	14

2.5 Bashkia Pogradec

a) Plazhi Pogradecit

- Gjatë monitorimit u vu re që zona pastrohej në mënyrë të vazhdueshme nga institucione përkatëse pranë Bashkisë Pogradec.
- Zonat e dedikuara për publikun kanë qenë të lira dhe në dispozicion të publikut dhe të pajisura me tabelat përcaktuese "Plazh Publik".

BASHKIA POGRADEC				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
29	30	1	29	29

2.6 Hapësirat publike:

Përgjatë vijës bregdetare të shtrirë në bashkitë Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Divjakë dhe përgjatë vijës bregliqenore Pogradec janë përcaktuar rreth 299 parcela për përdorim publik.

2.7 Bashkia Durrës

Bashkia Durrës ka shtrirjen më të gjatë të vijës bregdetare dhe në total për këtë bashki janë përcaktuar si parcela të lira për publikun 187 parcela të shpërndara sipas plazheve, më konkretisht:

- Plazhi Gjiri i Lalzit 5 parcela.
- Plazhi Hamallaj 3 parcela.
- Plazhi Katundi i Ri 82 parcela.
- Plazhi Currila 1 parcelë.
- Plazhi i Durrësit 60 parcela.
- Plazhi Shkëmbi i Kavajë 36 parcela.

Gjatë monitorimit të kryer në këto plazhe u konstatua si më poshtë vijon:

- Mungesë e pikave të vrojtimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit);

- Hapsirat ranore janë të pajisura më kontenierë/kosha me kapak për hedhjen dhe mbeturinave.
- Pastrimi i hapsirave publike është kryer dy herë në ditë nga “Ndërmarja e Shërbimeve Publike Plazh Durrës”.

2.8 Bashkia Kavajë

Bashkia Kavajë ka në administrimin e saj 64 parcela publike:

Gjatë monitorimit të kryer në Plazhin e Golemit u konstatua se ka mungesa me:

- Përcaktimi i hapësirave publike dhe njoftimi i tyre me anë të tabelave informuese;
- Sigurimi i pastrimit të sipërfaqeve ranore;
- Mungesa e kontenierëve/koshave me kapak për hedhjen e mbeturinave në një pjesë të parcelave publike;
- Mungesë e pikave të vrojtimit dhe vrojtuesve të certifikuar;
- Mungesa e shërbimeve higjenike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit);

2.9 Bashkia Rrogozhinë

Bashkia Rrogozhinë ka në administrimin e saj 35 parcela publike.

Gjatë monitorimit të kryer në Plazhin e Spillesë u konstatua si më poshtë vijon:

- Sigurimi i pastrimit të sipërfaqeve ranore;
- Mungesë e shërbimeve higjenike;
- Mungesë e pikave të vrojtimit dhe vrojtuesve të certifikuar;
- Mungesë e tabelave informuese dhe numrave të emergjencës.

2.10 Bashkia Divjakë

Bashkia Divjakë ka në administrimin e saj 2 parcela publike.

Gjatë monitorimit të kryer në Plazhin e Divjakës u konstatua si më poshtë vijon:

- Ndotje e pakët urbane në sipërfaqet ranore;
- Mungesë e shërbimeve higjenike;
- Mungesë e pikave të vrojtimit dhe vrojtuesve të certifikuar;
- Mungesë e tabelave informuese dhe numrave të emergjencës.

2.11 Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec ka në administrimin e saj 11 parcela publike.

Gjatë monitorimit të kryer në Plazhin e Pogradecit u konstatua si më poshtë vijon:

- Ndotje e ulët urbane;
- Mungesë e pikave të vrojtimit dhe vrojtuesve të certifikuar;

- Mungesë e tabelave informuese dhe numrave të emergjencës;
- Mungesë e shërbimeve higjenike.

3. Agjencia Rajonale e Bregdetit Vlorë, nën juridiksionin e së cilës kanë qenë Bashkia Vlorë dhe Bashkia Fier dhe ku situata me nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe praninë e vrojtuesve të plazhit, paraqitet si më poshtë vijon:

BASHKIA VLORE				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
136	139	3	136	136

- 3.1 Gjatë sezonit turistik 2020 është inauguruar plazhi Publik në Lungomare, investim i Bashkisë Vlorë me standarte bashkëkohore përkatësisht në muajin korrik 2020, ku çadrat dhe shezlonget ishin pa pagesë.
- 3.2 Po ashtu ka pasur një bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, Bashkitë e Vlorës dhe Fierit, Prefektin e Qarkut Vlorë, si dhe Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit.
- 3.3 Bashkia Vlorë ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun 22 parcela publike, ku ndër të tjera është konstatuar:
- Mungesë e pikave të vrojtimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
 - Mungesë e shërbimeve higjenike;
 - Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit);
- 3.4 Gjatë monitorimeve në terren, janë konstatuar problematika me:
- Mungesën elementesh plotësues të kullave të vrojtimit kryesisht në Zvërnec dhe Orikum;
 - Mungesën standartesh plazhet publike, mungesë sinjalistike dhe tabelash “Plazh Publik” në pothuajse gjithë zonën e Orikumit;
 - Praninë e mbeturinave plastike në zonën Seman, Darëzezë e Re;
 - Problematika të shkaktuara nga mbyllja e institucionit të Bashkisë Vlorë (rast covid pozitiv);
 - Vendosje elementë ndarës të llojit strukturë e lehtë metalike, gardh pengues për kalimin e lirshëm të publikut në Jonufër (rasti subjekti Veli Dervishaj, i cili pas ndërhyrjes së punonjësve të AKB-së ka hequr elementët ndarës);
 - Mungesë infrastrukture në plazhet Seman dhe Darëzezë e Re;
 - Mungesë infrastrukture, rruga e dëmtuar po ashtu dhe ndriçimi natën në rrugën që të çon në plazhin e Zvërnecit;

- h) Mungesë elementësh plotësues të kullës së vrotimit kryesisht në Seman, Zvërnec, Orikum;
- i) Prania e mbeturinave plastike dhe inerte kryesisht në Seman, Orikum;
- j) Mungon infrastruktura për personat me aftësi të kufizuara.

BASHKIA FIER				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrotimi	Vrojtues të certifikuar
51	51	0	51	51

3.5 Bashkia Fier ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun 9 parcela publike, të shpërndara sipas plazheve:

- Seman 4 parcela
- Dारेzeze 5 parcela

Në plazhet publike është konstatuar:

- Mungesë e pikave të vrotimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit);
- Problematika me pastrimin e zonës.

4. Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë, nën juridiksionin e së cilës kanë qenë Bashkia Sarandë dhe Bashkia Himarë dhe ku situata me nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe praninë e vrojtuesve të plazhit, paraqitet si më poshtë vijon:

BASHKIA SARANDË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrotimi	Vrojtues të certifikuar
123	126	3	123	123

4.1 Plazhet e Sarandës dhe Ksamilit:

- 4.1.1 Është konstatuar se përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit.
- 4.1.2 Është konstatuar ndotje e detit nga subjektet që sistemojnë plazhet dhe hedhin rërë jo cilësore duke shkatëruar kështu florën dhe faunën në zonë.
- 4.1.3 Vijon prania e mbetjeve inerte në anët e rrugës kryesore që të çojnë në Ksamil;

- 4.1.4 Pastrimi i mbetjeve urbane edhe pse ka përmirësime, përsëri nuk është në nivelet e duhura;
- 4.1.5 Në shëtitoren e Ksamilit në afërsi të plazheve mungon ndriçimi, uji dhe prania e firmës së pastrimit për mbledhjen e mbeturinave urbane;
- 4.1.6 Edhe pse në Ishujt e Tetranisit nuk lejohet të zhvillohet asnjë lloj aktiviteti privat pasi është zonë e mbrojtur, vijon të ushtrohet aktiviteti;
- 4.1.7 Në vijën bregdetare që shtrihet nga veriu i “Gjirit të Podajve” ka vazhdimisht ndërhyrje me gërmim dhe thyerje të shkëmbit, mbushje të detit me baza dhe materiale inerte, ndërtim të moleve artificiale si ndëtim mur guri, tarraca etj..
- 4.1.8 Në plazhet e Ksamilit është konstatuar se përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit;
- 4.1.9 Subjektet kanë qenë të pajisur me kullë vrojtimi, por nuk kanë patur elementët e saj;
- 4.1.10 Subjektet në përgjithësi kanë rrethuar hapësirat ujore për notim.
- 4.2** Bashkia Sarandë ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun **6** parcela të shpërndara sipas plazheve, më konkretisht:
- Sarande 5 parcela
 - Ksamil 1 parcele

Gjatë monitorimit të kryer në këto plazhe u konstatua si më poshtë vijon:

- Mungesë e pikave të vrotimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit).

BASHKIA HIMARË				
Kontrata të lidhura	Subjekte të monitoruara	Subjekte pa kontratë	Pika vrojtimi	Vrojtues të certifikuar
151	156	5	151	151

Vija bregdetare për zonën e Himarës (Lukovë, Bunec, Borsh, Qeparo, Llaman, Maraç, Porto Palermo, Potam, Himarë, Livadh, Jal, Dhërmi, Rrugët e Bardha Palasë).

4.3 Plazhi Bunec:

- 4.3.1 Nga monitorimi në plazhin e Bunecit është konstatuar se përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit;
- 4.3.2 Krahasuar me vitin e kaluar ka pasur përmirësim në plotësimin e kritereve të sigurisë (bova, pika vrojtimi dhe stacionet e mjeteve lundruese);
- 4.3.3 Subjektet kanë vendosur kosha mbeturinash, por kanë probleme me evadimin e tyre nga ana e Bashkisë;

- 4.3.4 Subjektet vijojnë të shprehin shqetësime për mungesën e infrastrukturës, mungesën e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm.

4.4 Plazhi Lukovë:

- 4.4.1 Mungon energjia elektrike, rrjeti i Ujësjellës-Kanalizimeve;
- 4.4.2 Subjektet që operojnë në këtë plazh kanë problem me plotësimin e kriterëve dhe standarteve të stacionit të plazhit;
- 4.4.3 Të gjitha subjektet në këte plazh operojnë me gropa septike jashtë standarteve;
- 4.4.4 Gjithashtu ka prezencë të bagëtive të imta dhe të trasha në plazhe.

4.5 Plazhi Borsh:

- 4.5.1 Ka mungesë të investimeve në infrastrukturë nga ana e Bashkisë, rehabilitimi i rrugës, mungesa e ndriçimit, ujit, gjelbërimit dhe mbledhja e mbeturinave;
- 4.5.2 Ka grumbullime të mbetjeve urbane dhe problematika me evadimin e tyre;

4.5 Plazhi Qeparo dhe Porto Palermo:

- 4.5.1 Në Plazhin e Qeparoit janë vendosur çadra dhe shezllone, por në përgjithësi mungonin tualetet, dushet, dhomat e zhveshjes, kullat e vrojtimit, etj;
- 4.5.2 Ka problematika me markimin e zonës së notimit dhe tabelat informuese.

4.6 Plazhi Llaman:

- 4.6.1 Rruga që të çon në plazhin e Llamanit është e pashtuar dhe pa sinjalistikë;

4.7 Plazhi Potam, Maraç& Himarë:

- 4.7.1 Në plazhin e Potamit dhe plazhin e Himarës përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit, kanë vendosur kosha mbeturinash, por mungojnë përgjithësisht bovat në hapësirën ujore;
- 4.7.2 Mungojnë tualetet dhe dhomat e zhveshjes, por në shërbim të pushuesve janë vënë tualetet e bareve dhe restoranteve.

4.8 Plazhi Livadh:

- 4.8.1 Rruga drejt plazhit të Livadhit, është e shtruar dhe e pajisur me sinjalistikë, ndërsa në zonën e plazhit është totalisht e pashtuar, pa ndriçim dhe pa sinjalistikë;
- 4.8.2 Nga kontrolli në plazhin e Livadhit është konstatuar se përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit;
- 4.8.3 Subjektet janë ankuar për mungesën e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimet e ujërave të zeza, si dhe mbledhjen e mbeturinave nga Bashkia.

4.9 Plazhi Jal:

- 4.9.1 Nga kontrolli në plazhin e Jalës është konstatuar se përgjithësisht subjektet respektojnë pjesën e hapësirës mes çadrave dhe nga vija e ujit;
- 4.9.2 Në stacionet e plazheve përgjithësisht mungojnë tabelat informuese.
- 4.9.3 Në plazhin e Jalit janë krijuar dy hot-spote për grumbullimin e mbetjeve urbane të pa autorizuara nga subjekte të papërgjegjshme.
- 4.9.4 Subjektet janë ankuar për mosofrimin nga pushteti lokal të ujit të pijshëm.

4.10 Plazhi i Dhërmiut:

- 4.10.1 Me përfundimin e punimeve të shëtitores problematikë krijon mosafaltimi i rrugës në krahu e sipërm të hoteleve për shkak të pluhurit, trafikut dhe pamundësisë për të marrë shërbimet.
- 4.10.2 Mangësi janë konstatuar në plotësimin e kriterëve, rrethimi me bova, vendosja e flamujve të sigurisë dhe tabelat informuese.

4.11 Plazhi Perivol:

- 4.11.1 Përgjatë plazhit të Perivolit, rruga e shëtitores është e pashtuar deri në fund, pa ndriçim dhe pa sinjalistikë;
- 4.11.2 Mangësi kishte në plotësimin e disa nga kriterëve, rrethimi me bova, flamujt e sigurisë, dhe tabelat informuese.

4.12 Plazhi “Rrugët e Bardha”, Palasë:

- 4.12.1 Një pjesë e rrugës hyrëse, në Plazhin e Rrugëve të Bardha, paraqitet e mirë dhe me sinjalistikë, është e shtruar, e gjerë dhe me trotuar, ndërsa segmenti rrugor, që të çon drejt plazhit, jo i shtruar dhe pa sinjalistikë;
- 4.12.2 Stacionet e plazhit kishin pika vrojtimi dhe vrojtues të certifikuar, por përgjithësisht mungonin tabelat informuese.

4.13 Hapësirat publike:

Bashkia Himarë ka patur të përcaktuar si parcela të lira për publikun 64 parcela të shpërndara sipas plazheve, më konkretisht:

- Palase 1 parcele
- Drimadhes 8 parcele
- Dhërmi 5 parcele
- Jale 3 parcele
- Livadh 4 parcele
- Himare 9 parcele

- Qeparo 6 parcela
- Borsh 22 parcela
- Bunec 2 parcela
- Lukove 4 parcela

Gjatë monitorimit të kryer në këto plazhe u konstatua si më poshtë vijon:

- Mungesë e pikave të vrojtimit si dhe vrojtuesit e certifikuar;
- Mungesë e shërbimeve higjienike;
- Mungesë e elementëve të tjerë të sigurisë në det (markimi i zonës së notimit).

5. Persona të mbytur për sezonin turistik veror 2020:

Në total për këtë sezon turistik u shënuan 19 raste të mbytjes së personave në det. Kryesisht ne zonën e Durrësit, Velipojës dhe Shëngjinit. Shkaku kryesor i mbytjeve sipas të dhënave nga policia mbetet arresti kardiak nga kontakti me ujin e ftohtë.

6. KONKLUZIONE

1. Për këtë sezon veror turistik subjektet janë pajisur me kontratën për ushtrimin e veprimtarisë së plazhit në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullore "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", të ndryshuar.
2. Subjekteve i është sjellë në vëmendje rëndësia e respektimit të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullore "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar dhe kanë patur kohën e mjaftueshme për marrjen e masave për zbatimin e tyre. Veçanërisht është theksuar plotësimi i kriterëve që lidhen me garantimin e jetës dhe sigurisë së pushuesve në plazhe, të tilla si pika e vrojtimit, vrojtuesit e certifikuar dhe markimi i zonës së notimit.
3. Problematikë, vijon të paraqesë ofrimi i standarteve në plazhet publike. Veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullore "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", i ndryshuar dhe ku për secilën bashki renditen rekomandimet si më poshtë vijon:
 - 3.1 Tabelizimi i të gjitha hapsirave publike, ku të paraqitet termi "PLAZH PUBLIK" si dhe numrat e emergjencës dhe këshillat për pushuesit;
 - 3.2 Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapsirave publike me vrojtues të certifikuar;
 - 3.3 Siurimi i pastrimit të paktën 2 herë në ditë të hapsirave publike;

3.4 Pajisja e hapsirave publike me shërbime higjienike;

3.5 Markimi i zonës së notimit;

4. AKB është e mendimit se procesi i lidhjes së kontratave me subjektet që do të operojnë me veprimtarinë e stacionit të plazhit deri në muajin Mars të çdo viti duhet të jetë i mbyllur, ndaj rekomandohet fillimi i procesit sa më shpejt të jetë e mundur.
5. Gjithashtu nevojitet evidentimi i saktë i subjekteve që operojnë me kontrata në zonën bregdetare dhe bregliqenore, si dhe markimi i tyre në hartën e përgjithshme të plazheve.
6. Nga AKB janë trajtuar të gjitha ankesat e mbërritura nga subjekte të ndryshme, të cilat pas verifikimit nga specialistët e AKB-së tek një pjesë është ndërhyrë ndërsa pjesa tjetër janë përcjellë për trajtim pranë institucioneve kompetente.